

ISSN 1127-8579

Pubblicato dal 06/05/2010

All'indirizzo <http://www.diritto.it/docs/29466-kednj-rol-i-dhe-r-nd-sia-e-saj-koncepti-i-gjykimeve-civile-dhe-r-nd-sia-e-realizimit-t-tyre-sipas-rregullave-pro-eduriale>

Autore: Joniada Musaraj

Kednj, roli dhe rëndësia e saj. Koncepti i gjykimeve civile dhe rëndësia e realizimit të tyre sipas rregullave proçeduriale

CEDU, il ruolo e la sua importanza. Il concetto di processi civili e l'importanza della loro attuazione, in conformità alle regole procedurali

Joniada MUSARAJ

“ KEDNJ, roli dhe rëndësia e saj. Koncepti i gjykimeve civile dhe rëndësia e realizimit të tyre sipas rregullave procedurale”. (“CEDU, il ruolo e la sua importanza. Il concetto di processi civili e l'importanza della loro attuazione, in conformità alle regole procedurali)

Paraprakisht do trajtojmë rolin dhe rëndësinë e KEDNJ, si një nga konventat më të arrira dhe të rëndësishme në afirmimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut e nënshkruar që më 1950, konventë që do t'a gjejmë gjatë gjithë punimit të tezës. Ky traktat është unik në llojin e tij. Konventa përfshin midis të tjerave të drejtën e jetës; mbrojtjen kundër torturës dhe trajtimit çnjëzëzor; lirinë dhe sigurinë; *të drejtën për një proçës të rregullt gjyqësor*; të drejtën për të respektuar jetën private të çdonjërit dhe jetën familjare etj. Protokollët që kanë pasuar në vite kanë shtuar të drejta të tjera përveç atyre të parashtruara në konventë, si heqja e dënimit më vdekje (Protokolli Nr.6). Shqipëria është pjesë e kësaj konvente që nga 29 korrik 1996. Me anë të këtij traktati, Shqipëria dhe 39 vende të tjera evropiane, janë angazhuar të garantojnë respektimin e disa të drejtavë themelore të njeriut për të gjithë qytetarët që ndodhen nën juridiksionin e tyre. Këto të drejta duhet të jenë, dhe sigurisht janë , të siguruara më mirë në nivel kombëtar. Kjo edhe për faktin se meqënëse qeveritë vendase janë më pranë individit dhe janë në dijeni për atë çka ndodh rreth tij, mjetet dhe mënyrat e përdorura nga to, priten të jenë më efektive se ato ndërkombëtare. Kështu Kushtetuta shqiptare, përmban kryesisht të njëjtat të drejta me ato të konventës. Kontrolli ndërkombëtar i zbatuar nga institucionet e përcaktuara nga konventa është dhe duhet të jetë vetëm dytësor. Megjithatë roli i tij është shumë i rëndësishëm. Rëndësia e kësaj konvente nuk qëndron vetëm në numrin e madh të të drejtavë të përfshira në të, por gjithashtu në mekanizmat mbrojtës të vendosura në Strasburg për të hetuar shkeljet e kallëzuara dhe për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga konventa. Çështjet e zhvilluara përpara Komisionit Europian¹ dhe GJEDNJ (ndryshe Gjykata e Strasburgut)², kanë zhvilluar më thellë

¹Komisioni Europian është krijuar në vitin 1954.

²GJEDNJ është themeluar në 1959. Për t'u bërë ballë sfidave të “Europës së madhe”, pra zgjerimit të saj, u vendos në Samitin e Vjenës 1993, që të krijohej një Gjykatë e re evropiane e të drejtave të njeriut me një nivel të vetëm duke zëvendësuar sistemin e vjetër me dy nivele. Kjo gjykatë ka filluar punimet e saj më 1 Nëntor 1998.

dispozitat e konventës dhe kanë ushtruar një influencë gjithnjë e më të thellë mbi ligjet dhe realitetet shoqërore të shteteve anëtare. Gjykatat kombëtare të shteteve anëtare të konventës, kur vendosin mbi një çështje për të drejtat e njeriut, i referohen gjithnjë e më tepër vendimeve të Strasburgut dhe zbatojnë standartet dhe parimet e vendosura atje. Gjithashtu mund të përmenden shume raste të modifikimit të legjislacionit të shteteve dhe të praktikave administrative përpara ratifikimit të konventës nga ana e tyre, veçanërisht në rastin e atyre shteteve që i janë bashkuar së fundmi Këshillit të Europës.³

Krahas Komisionit European dhe GJEDNJ, në vitin 1999, u krijua funksioni i Komisionerit të të drejtave të njeriut. Ai ka për mision promovimin e edukimit dhe sensibilizimin me të drejtat e njeriut në shtetet anëtare. Ai kujdeset për respektimin e plotë dhe efektive të teksteve të Këshillit të Europës si konventat, rekomandimet dhe rezolutat e miratuara nga Komiteti i Ministrave. Ai nuk ka fuqi juridike, por një rol informues dhe këshillimor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e dhunimit të tyre. Termat e referencës së Komisionerit parashikojnë gjithashtu bashkëpunimin me institucione të tjera ndërkombëtare të përfshira në nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mundësinë e veprimit për informacione të vlefshme që merren nga qeveritë, parlamentet kombëtare, Avokati i Popullit i çdo vendi anëtar, apo institucione të tjera të ngjashme, nga individët dhe organizatat. Të gjitha këto bëjnë të mundur rritjen e besimit të qytetarëve europian ndaj KEDNJ dhe GJEDNJ, se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të padhunueshme, të patjetërsueshme dhe të pandashme.

Në këtë temë do të trajtohet procesi i rregullt e i drejtë gjyqësor, i cili ka një rëndësi të madhe për një shoqëri dhe ekzistencës së një demokracie funksionale. Gjithashtu kjo e drejtë është më e prekshme kur një individ është pjesë e një procesi gjyqësor në të cilin nuk është respektuar detyrimi që buron nga neni 6 i konventës. Si rrjedhim, për këtë shkak, neni 6 të KEDNJ nuk mund t'i bëhet një interpretim i ngushtë pasi në disa raste kjo do të sillte shmangie nga kuptimi i dhënë nga kjo konventë për këtë të drejtë.

Neni 6 pr. 1 i konventës parashikon procesin e drejtë gjyqësor, për aq më tej i përcaktuar në fjalë të jetë një kundërshtim në lidhje me një të drejtë apo detyrim civil (ky kundërshtim vlen edhe për çështjet penale).

³Shih më gjerë Denar Biba, "Të Drejtat e Njeriut në të Drejtën Ndërkombëtare".

E drejta për gjykim të drejtë është një masë mbrojtëse e cila garantohet në dokumenta ndërkombëtarë të të drejtave të njëriut siç janë DUDNJ si dhe në KEDNJ, e cila është e detyrueshme për Shqipërinë si një shtet kontraktues i saj. E drejta për një gjykim të drejtë është një koncept i gjerë, i cili është zhvilluar më së shumti nga GJEDNJ. Një koncept i zhvilluar nga praktika gjyqësore e GJEDNJ është se KEDNJ garanton të drejta që janë praktike dhe efektive në vend të atyre që janë teorike dhe joreale. Kjo do të thotë se të drejtat interpretohen më gjerësisht, pra nuk mjafton që këto të drejta të garantohen formalisht, ato duhen siguruar që në të vërtetë zbatohen në praktikë për personin në fjalë.

Boshti i punimit do të jetë gjykimi civil përballë procesit të drejtë gjyqësor dhe vështirësi që has ai për t'u zhvilluar në mënyrë të drejtë, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme si dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor. Koncepti i gjykimit civil në pikëpamjen time paraqitet: “gjykimi civil është një tërësi aktesh gjyqësore dhe veprimesh të kryera nga subjektet proceduriale, me qëllim vërtetimin apo rrëzimin e pretendimeve të ngritura nga palët me anë të marrjes së vendimeve të ndërmjetme⁴ dhe atij të formës së prerë.”⁵

Në rast të konfliktit midis individit dhe pushtetit publik nuk është me rëndësi nëse një organ i caktuar vepron në cilësinë e subjektit civil, apo në cilësinë e mbartësit të pushtetit publik, me rëndësi është karakteri i së drejtës që implikohet. Por në interpretimin e “të drejtave dhe të detyrimeve civile”, gjykata nuk mund të vendosë në mënyrë të pavarur mbi ekzistencën e të drejtave materiale, që nuk janë të bazuara në të drejtën e brendshme. Neni 6 par.1 i konventës është i zbatueshëm nëse pretendimi është për nga natyra i vlersueshëm në para,⁶ buron nga shkelja e të drejtave, që gjithashtu kanë të njëjtin karakter, pavarësisht burimit të konfliktit apo juridiksionit të gjykatave. Një përfundim i tillë është arritur nga GJEDNJ-ja në çështjen “*Editions Pèriscope kundër Francës*”⁷. Në këtë çështje gjykata u shpreh se neni 6 i konventës

⁴Janë vendime me anë të të cilave gjykata shprehet mbi kërkesat e palëve gjatë gjykimit si psh kërkesa për marrjen e një prove apo thirrjen e një dëshmitari.

⁵Vendim i formës së prerë që shprehet mbi themelin e çështjes.

⁶Ka të drejta të tilla si psh ajo e respektimit të jetës familjare që nuk konvertohen në para.

trajton dhe ka objekt të saj in të drejtat ose mosmarrveshjet civile, pa marrë parasysh nëse ato janë të njohura si të tilla në të drejtën vendase.

Pra sipas gjykatës, e rëndësishme është që për t'ju drejtuar GJEDNJ duhet të pretendojmë në ato raste kur kemi të bëjmë me të drejta civile sipas KEDNJ dhe jo domosdoshmërisht sipas të drejtës vendase.⁸ Sipas të drejtës vendase, në këtë çështje, nuk kemi të bëjmë me asnjë të drejtë civile. Nëse do të pranohej opsioni i kundërt, atëherë sipas tyre neni 6 i konventës u zbatoka në çdo rast pavarësisht nga e drejta që implikohet. Sipas GJEDNJ, e drejta në fjalë është një e drejtë civile, pavarësisht origjinës së mosmarrveshjes dhe faktit nëse gjykatësit kishte apo jo kompetencë për t'a gjykuar çështjen. Pra si përfundim themi se nuk përjashtohet mundësia që një e drejtë publike sipas të drejtës vendase, të konsiderohet si e drejtë civile sipas nenit 6 të konventës apo anasjelltas. Ky nen shtrihet edhe në ato proçese, në të cilat nuk mrrren vendime direkt për të drejtat dhe detyrimet civile, por që kanë për to një rëndësi të madhe.

Gjykimi i çështjçvë gjithmonë duhçt të respektojë rregullat proçeduriale të vendosura nga normat kombëtare por duke respektuar edhe standartet eropiane. Jo gjithmonë një gjykim, qoftë ky përpara organeve të administratës apo gjykatave mund të respektojë proçesin e rregullt gjyqësor ose siç njihet nga KEDNJ, "fair trial". Kjo e drejtë në vetvete përmban një tërësi garancish ku ne do të ndalemi te tri elementët e "të drejtës për një proçes të drejtë gjyqësor", objekt studimi i kësaj teze.

E drejta për një proçes të drejtë gjyqësor është një nga të drejtat themelore që i njihen individit dhe më saktë e drejtë pozitive, pasi për realizimin e saj me efikasitet kërkohet ndërhyrja e shtetit, kuptohet me anë të organeve kompetente. Kujdesi që duhet treguar në respektimin e proçesit të rregullt apo të drejtë gjyqësor gjatë një gjykimi civil, duhet të jetë maksimal. Për këtë nevojitet jo vetëm vigjilënca e organeve administrative dhe gjykatave ndaj detyrimeve ligjore të tyre (ku përfshihet dhe detyrimi për të respektuar proçesin e rregullt apo të drejtë gjyqësor), por dhe interesi i vetë individit për t'a kërkuar një të drejtë të tijën. Mungesa e një interesi të tillë, të siguron se askush nuk do t'a bëj një gjë të tillë në vendin tënd pa treguar ti, se kërkon t'a gëzosh

⁷Shih më tej çështjen Editions Përiscope kundër Francës, datë 26 Mars 1992, par.35-40 i vendimit.

⁸Shih më gjerë Neves dhe Silva kundër Portugalisë, datë 27 Prrill 1989.

të drejtën tënde të zhveshur nga cënimi që bie mbi të. Individit gjithmonë i është ofruar mundësia të kundërshtojë gjykime civile, në të cilat ai ka bindjën se nuk është respektuar e drejta për një proces të drejtë gjyqësor dhe si rrjedhim e drejta e tij subjektive nuk është relizuar. Individu duhet të nxitet se askush tjetër përveç tij nuk e di se kur dhe në ç'mënyrë ai duhet t'a pretendojë një gjë të tillë. Së pari do doja t'ju jepja një panoramë të shkurtër të asaj që sot njihet pothuajse në të gjitha sistemet juridike si proces i drejtë gjyqësor. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të miratuar më 1998 e gjejmë të shprehur në mënyrë të qartë, dukë mos lënë hapsira për keqinterpretime në nenin 42 të saj:

1. liria, prona dhe të drejtat e njohura me kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt gjyqësor;

2. kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe nga një gjykatë e pavarur dhe kompetente.

Në nenin e mësipërm ajo që vërehet është se në pikën e parë të tij, sanksionohet procesi i rregullt gjyqësor për liritë, të drejtat dhe PRONËN. Kjo gjetje nuk mendoj se është bërë pa një shkak llogjik pasi nëqoftëse të gjitha liritë dhe të drejtat e njeriut nuk janë përmendur specifikisht njëra pas tjetrës, për të drejtën e PRONËS legjislatori ka vendosur t'ja bëj me dije individit se çfarë peshe zë "Prona" te të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ajo që mungon në dispozitën e mësipërme është dhënia e konceptit të "procesit të rregullt ligjor" edhe pse ajo del qartë jo vetëm nga formulimi i kësaj të drejtë në KEDNJ, por akoma më e detajuar në praktikën e Strasburgut. Për këtë arsye në këtë dispozitë, legjislatori ka menduar t'a shprehë sa më mirë qëllimin e tij në dy drejtime:

- së pari e drejta e pronës është vendosur në krye të nenit 42;
- së dyti ajo është veçuar nga liritë dhe të drejtat e tjera, duke u shkruar në mënyrë eksplicite (liria, prona...).

Për këto dy arsye është e rëndësishme që neni 42 jo vetëm të kuptohet drejtë por të zbatohet me përpikmëri në mënyrë të tillë që të arrihet qëllimi i vendosur nga Kushtetuta. Duke qenë se e drejta e pronës është një nga të drejtat më të ndjeshme për individin, është i justifikuar fakti që në

praktikën shqiptare dhe atë të GJEDNJ, ka shumë raste ankimimi për mosrealizim të një gjykimi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm dhe nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme civile. Kjo do duket qartë kur të trajtojmë në vazhdim problemin e zhvillimit të procesit civil në mënyrë të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm dhe nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, me objekt pronësinë.

Në fakt e drejta e pronës është e garantuar me ligj. Me mbështetjen e OSBE-së u përgatit e legjislacioni i ri që do të zgjidhë kërkesën kushtetuese të paplotësuar prej kohësh lidhur me kthimin dhe kompensimin e tokës së konfiskuar gjatë regjimit komunist. Projekt-ligji përfundimtar për Njohjen, Kthimin dhe Kompensimin e Pronave iu dorëzua Kuvendit në nëntor 2003. Dy forcat politike kryesore e mbështetën në parim këtë projekt-ligj, ndërsa partitë e vogla opozitare dhe shoqatat e ish-pronarëve shprehën kundërshtime të forta lidhur me pjesët që kanë të bëjnë me kthimin apo kompensimin financiar. Megjithëse mund të mos zgjidhë në mënyrë të kënaqshme pretendimet e të gjitha palëve, në rast se zbatohet si duhet, ky projekt-ligj do të zgjidhte në një masë të gjerë këtë çështje e cila vazhdon të pengojë zhvillimin social-ekonomik të Shqipërisë. Në çdo rast, qeveria shqiptare duhet sa më shpejt të jetë e mundur të vërë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm për të përcaktuar tokën e lirë për kthim dhe kompensim. Ajo duhet të identifikojë kërkesat e pazgjidhura për kthim dhe kompensim dhe të hartojë një plan financiar për mbulimin e kostos së mundshme të kompensimit.⁹

Duke u rikthyer te "prosi i dejtë", detyra të faktshme se ky grani vlen dhe për bakimin e proçedurës, përse këtu detyri i këtij proçeduri është pjesë e rrit 6 të konstitucës. Për shkak: në një proçedurë doçi që përfshin detyrë të huja, shprehja e bakështetëse është një çështje papade, sepse ligji substancial në fuqi në këtë rast varet nga problemi de vërteti i marrë në këtë dejm nga organ kompetent administrativ; ngjiturë, në lidhje me proçedurën e kombësë, ky është e saktonur në rrit 6. K ështëu bëhet e mundur dhënia e shprehje të shuntë të proçedurës që janë në një mënyrë ose në një tjetër nensarëshje në lidhje me një të dejtë civile, por që nuk do të futë se proçedura në fjalë do të rregullohet nga rrit 6, par. 1 (riti 6-1).

Ky rast jip një shkakull tjetër. Rezultatet e proçedurës kulturore ngjirin në një çështje papade për nensarëshje civile. Megjithatë, detyri i proçedurës kulturore nuk është një nensarëshje në lidhje me një të dejtë civile, por shprehja e kulturorë së një ligji. Për më tepër, proçedura përfshirë për rryshimin e ligjit në fjalë do të jetë "papade" në një nensarëshje civile, por shprehja nuk do të përfshijë të zotë të nat

⁹Raporti i Bashkimit Europian viti 2004.

një proces të neni 6 për ab. N ë se aplikimi i kësaj rregullore në bazë të kësaj të përcaktuar ligj, anë në përfundim e keni: jo-zbatimin e neni 6 pr. 1 (art. 6-1) në procedurë kushtetuese në këtë rast. N ë çdo rast, ab nuk janë të njëjta për të siguruar aspe të fita de bide për zbatimin e neni 6 pr. 1 (art. 6-1) në një procedurë të veçantë.

Megjithatë parimi kryesor është se në rast se do të kemi dyshime, nëse në një çështje të caktuar do të zbatohet apo jo neni 6 i konventës, përgjigja duhet të jetë pozitive, përse kohë një zbatim i tillë është i mundshëm për t'u kryer. Në vendimin “*Delcourt kundër Belgjikës*”, GJEDNJ theksoi në vendimin e saj se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor është kaq i rëndësishëm aq sa nuk mund të mjaftohemi me një interpretim të ngushtë të nenit 6 të konventës, pasi do të venitej si qëllimi ashtu dhe karakteri i saj. Neni 6 i konventës duhet të interpretohet duke marrë parasysh jo vetëm parimet themelore të rendit juridik të shteteve anëtare, duke përfshirë këtu psh parimin se çdokush ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës por edhe mbi parimet e përgjithshme të konventës dhe gjithë jurisprudencës së saj.

Një nga mjetet efikase për t'u drejtuar, kur ne pretendojmë shkeljen e një te drejtë, është Gjykata Kushtetuese. Ky mjet ankimi i përgjithshëm, i cili mund të përdoret për shqyrtimin e ankimeve, që nuk mund të trajtohen nëpërmjet mjeteve ankimore të veçanta. Në disa shtete anëtare, ky mjet ankimi i përgjithshëm mundet gjithashtu të ushtrohet paralelisht me ose madje edhe përpara se të jenë shtetur mjetet e tjera ligjore të ankimit. Disa shtete anëtare kanë shtuar kushtin se masa objekt ankimi do të cënonte rëndë të drejtat kushtetuese dhe se refuzimi (nga ana e Gjykatës Kushtetuese) për ta trajtuar ankimin do të sillte pasoja serioze dhe të pariparueshme për ankuesin. Duhet vënë në dukje se shtetet që kanë një mjet të tillë ankimi të përgjithshëm janë të prirur të kenë më pak çështje përpara Gjykatës. Duke pasur parasysh parashtrimin e mësipërm, janë shtetet anëtare ato që vendosin se cili sistem është më i përshtatshëm për garantimin e mbrojtjes së nevojshme të të Drejtave Konvencionale, duke pasur parasysh traditat e tyre kushtetuese dhe rrethana të tjera të veçanta.

Kopetenca e GJ.K për të vendosur për pretendime në lidhje me procesin e rregullt ligjor, nuk ka pas si qëllim që kjo gjykatë të dublonte gjykatat e zakonshme duke u kthyer në disa raste si gjykatë e shkallës së katërt, kur dihet që KEDNJ mjaftohet vetëm me garantimin e një apeli. Keto konstatime janë rezultat i mendësive politike, institucionale dhe profesionale.^D Vendimet e

^DMe gjerë shih: “Sistemi gjyqësor në provën e funksionimit të kushtetutës” Theodhori Sollaku, revista shkencore e UET “Jus&Justicia” Nr.2, 2008, fq 64.

fundit të GJ.K të Shqipërisë përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në teorinë dhe praktikën e së drejtës kushtetuese shqiptare. GJ.K shqiptare në këto 10 vjet, e ka interpretuar në mënyrë të gjerë dhe krijuese Kushtetutën, sidomos në rastet e mbrojtjes së të drejtave individuale. Në vendimet e saj, jo vetëm janë detajuar garancitë e përmendura në Kushtetutë, por edhe janë afirmuar elemente të reja garantuese. Në fakt, e gjitha kjo që ndodh është një hapsirë e krijuar dhe e lejuar nga vetë Kushtetuta, e cila e ka thirrur drejtpërdrejt KEDNJ për të garantuar shkallën e kufizimeve të të drejtave kushtetuese, i ka vendosur marrveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me fuqi mbiligjore, si dhe i ka dedikuar Gjykatës sonë Kushtetuese të drejtën për të kontrolluar pajtueshmerinë e ligjeve të brendshme me ato ndërkombëtare. Në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme, ajo i referohet shpesh vendimeve të GJEDNJ por edhe vendimeve të gjykatave të vendeve të tjera demokratike, si dhe doktrinave më të reja kushtetuese.¹¹ GJ.K e Shqipërisë, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, shfaqti me autoritet e dinjitet rolin e saj të rëndësishëm si garante e Kushtetutës së vendit. *Vendimi nr. 75, datë 19 prill 2002* afirmon parimin e rëndësishëm të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 42 par.1, parim i cili duhet zbatuar edhe në procedurat për shkarkimin e funksionarëve të lartë të sistemit gjyqësor dhe të akuzës. Gjykata në vendimin e saj thekson se i takon ligjvënësit dhe jo asaj të krijojë normën juridike procedurale. Megjithatë gjykata identifikon katër elementë bazë të procesit të rregullt ligjor që duhen mbajtur parasysh në përcaktimin e normave dhe procedurave të shkarkimit, të cilat janë: argumentimi i shkeljeve, parimi i ndarjes së pushteteve gjatë shqyrtimit, njohja paraprake me materialet akuzuese dhe e drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Nga ana tjetër, *Vendimi nr. 76, datë 25 prill 2002* vleron se procedurat e shkarkimit të ndjekura nga Kuvendi dhe Presidenti nuk ishin në pajtim me parimet kushtetuese dhe kërkesat e nenit 42 par.1 të Kushtetutës, dhe për këtë arsye GJ.K i shfuqizoi ato. Të dyja vendimet e GJ.K përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në të drejtën kushtetuese shqiptare dhe në jurisprudencën përkatëse. Për rëndësinë e tyre të veçantë në përmbajtje, për forcën dhe thellësinë e argumentimit juridik, për faktin se ato janë marrë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, pavarësisht nga trysnia e jashtëzakonshme politike e ushtruar, këto vendime marrin përmasa historike. GJ.K me këto

¹¹ Me gjerë shih: "Garancitë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut" Eralda Methasani, revista shkencore e UET "Jus&Justicia" Nr.2, 2008, fq 22.

vendime ripohon autoritetin e saj si garante e Kushtetutës dhe si interpretuesja përfundimtare e saj. Ajo përcjell qartë mesazhin se, në funksion të rolit të saj të rëndësishëm kushtetues, ajo nuk do të tolerojë shkelje apo cënime të Kushtetutës, pavarësisht se nga cilat palë bëhen ato.²

GJ.K është e ngarkuar të vendosë, lidhur me ankesat kushtetuese të bëra nga individët që pretendojnë shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë. GJ.K e ka zgjeruar kuptimin e së drejtës për gjykim të drejtë, e cila tani përfshin edhe disa të drejta shtesë. Që nga krijimi i GJ.K më 1992, kjo gjykatë ka vendosur mbi një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor, sidomos pas vitit 1998, kur Kushtetuta e re ka hyrë në fuqi. Gjykata e ka konsideruar mbrojtjen e të akuzuarit nëpërmjet ndihmës ligjorë, si një element të gjykimit të drejtë.

Një përshkrim statistikor i paraqitur nga qeveria tregon se me 2002 GJ.K ka vendosur për 243 kërkesa, 197 prej të cilave janë konsideruar të papranueshme *de plano*. Në 2003 gjykata ka vendosur mbi 279 kërkesa, 240 prej të cilave janë deklaruar të papranueshme *de plano*. Në 2002 dhe në 2003, 37 çështje janë deklaruar të pranueshme kanë pasur të bëjnë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Në fakt objekt shqyrtimi i GJ.K është cenimi “Proçesit të rregullt ligjor”(due process law)³ dhe jo të gjitha liritë dhe të drejtat e njeriut. Jam e mendimit se do të kishte qenë akoma me frytdhënëse një GJK e cila do të shqyrtonte të gjitha shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në të vërtetë ajo do të përballëj me një dyndje çështjesh, por duke qenë se individi është shumë kërkuar ndaj të drejtave dhe lirive të tij, besoj se profesionalizmi i anëtarëve të GJK do t’a përballonte një fluks të tillë.

Për këtë çështje Kristaq Traja⁴ është shprehur se ndoshta arsyeja e mosrealizimit të një GJK që do të gjykonte të gjitha shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut, të ketë ndikuar frika e fuqizimit të frikshëm të saj dhe rritjes në një masë shumë të madhe të kompetencave. Prandaj, GJK u mendua

²Ide të shprehura nga konstitucionalisti i njohur Agron Alibali.

³Në vijim do trajtojmë dallimet dhe ngjashmeritë midis një procesi të rregullt gjyqësor (Kushtetuta Shqiptare) me atë të drejtë gjyqësor (GJEDNJ).

⁴Një nga gjyqtarët e GJEDNJ për Shqipërinë.

si një gjykatë ku individi do të mund të drejtohet vetëm për shkelje të procesit të rregullt ligjor. Në atë kohë u shpreh dhe Kuvendi, sipas të cilit nëqoftëse ne sigurojme në GJK, të drejtën për një proces të rregullt ligjor, njëkohësisht kemi siguruar dhe liritë dhe të drejtat e tjera të individit. Mendoj se ky qëndrim i Kuvendit nuk ka qenë i drejtë, pasi nuk mund të vendosim NE se një e drejtë e individit, sado e rëndësishme të jetë, nuk mund të njihet si sinonim i të gjitha të drejtave të tjera. Për më tepër që një proces gjyqësor mund të jetë në fakt një proces i rregullt ligjor, por nuk do të thotë se është zgjidhur drejtë. Prandaj gjykata gjatë gjykimit të çështjeve, duhet të jetë e kujdesshme që t'i përmbahet “fair trial” të parashikuar nga KEDNJ. Si konkluzion themi se pavarësisht nga formulimi që gjejnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ato në thelbin e tyre duhet të interpretohen dhe zbatuar në përputhje me praktikën gjyqësore të Strasburgut.⁵ Të drejtave dhe lirive të parashikuara nga KEDNJ u është dhënë një status kushtetues.⁶

1.2 Roli i individit në realizimin e një procesi civil të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm kohor, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Në drejtim të edukimit dhe informimit të shoqërisë shqiptare janë kryer një sërë aktivitete nga Këshilli i Evropës për lehtësimin e aksesit të qytetarëve pranë GJEDNJ. Për ndërgjegjësimin dhe njohjen e qytetarëve me GJEDNJ janë botuar broshura dhe publikime të ndryshme me synim lehtësimin e shfrytëzimit të këtij instrumenti efektiv ndërkombëtar në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Individi duhet të mundësojë aksesin e tij në GJEDNJ për mbrojtjen e të drejtave të tij.

Si rezultat, vihet re se aksesin e qytetarëve shqiptarë ndaj GJEDNJ ka ardhur duke u rritur dhe sensibilizimi i tyre ka filluar të japë efektet në numrin e çështjeve të paraqitura për shqyrtim para saj. Një tjetër aktor lehtësues mund të jenë dhe organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut⁷. Rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit të këtyre

⁵Shih më tej Kristaq Traja “Kushtetuta dhe sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut” botuar në “Kushtetuta e re shqiptare, sfida e së ardhmes euroatlantike të Shqipërisë”, LUARASI, Tiranë 2002.

⁶Po aty.

⁷Aktualisht, janë disa organizata jofitimprurëse që po kryejnë një funksion të tillë. KShH ka mbi 2 vjet që po kontribuon në drejtim të edukimit dhe informimit të qytetarëve, organizatave të tjera lokale për rolin e GJEDNJ në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

organizatave po i kushtohet një vëmendje e veçantë nga KE dhe donatorë të tjerë. Në këto kushte krahas institucioneve përgjegjëse shtetërore dhe shoqëria civile ka filluar të jetë më e sensibilizuar për rolin e saj në këtë mekanizëm ndërkombëtar në favor të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ndonëse iniciativat në këtë drejtim janë embrionale, ato janë premtime për të ardhmen e afërt. Në nivel krahasues me shoqërinë civile në një nivel më të lartë përgatitje janë zyrat avokatore që kanë filluar të përfaqësojnë çështjet e individëve para GJEDNJ. Por, megjithatë, ato janë ende larg nivelit profesional që duhet të kenë për të prezantuar sa më shumë çështje pranë GJEDNJ. Prezantimi i sa më shumë çështjeve pranë GJEDNJ nuk është tregues negativ. Përkundrazi është një shtysë shumë e mirë për përmirësimin në përgjithësi të të drejtave të njeriut në vend. Megjithatë, nga ana tjetër çdo shteti dhe shoqëri i intereson që ankesat e individëve për shkelje të të drejtave të parashikuara në KEDNJ të mund të zgjidheshin brenda sistemit kombëtar.

Pavarësisht, numrit të vendimeve të dhëna ndaj vendit tonë ndikimi i tyre në sistemin e brendshëm shqiptar është i drejtpërdrejtë. Nga një analizë e disa prej vendimeve më kryesore të dhëna nga GJEDNJ ndaj Shqipërisë vihet re se problemet e konstatuara në sistemin e brendshëm shqiptar si dhe rekomandimet për marrjen e masave me karakter të përgjithshëm janë serioze, të rëndësishme dhe mjaft relevante. Disa prej këtyre vendimeve evidentojnë shqetësime thelbësore të sistemit të brendshëm shqiptar, të cilat kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme të institucioneve përgjegjëse shtetërore për reformimin e tij dhe përshtatjen me standartet e KEDNJ.⁸

Ka shume arsye pse individi shpeshhere e gjen veten si palë në një gjykim civil, ku pretendon një të drejtë që i është shkelur apo cënuar ose kur ai kërkon të shmangë pengesat që ai mund të hasë në të ardhmen në gëzimin qetësisht të të drejtës së tij. Gjykimet civile duke qenë se kanë një fushë të gjerë veprimi, është e rëndësishme por edhe e detyrueshme që të kryhen në përputhje me ligjin, pasi një individ nëse pretendon se i është cënuar një e drejtë, duhet të gjej zgjidhje të problemit të tij vetëm në gjykatë dhe jo në rrugë jashtëgjyqësore. Shtetet shpeshhere kanë hasur në vështirsi në sigurimin e individëve, se ata do të jenë të qetë në gëzimin e të drejtave dhe lirive

⁸Shih më tej Ersida Sefa "Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe impakti i saj në respektimin e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri", Tiranë,2008.

të tyre. Mjetet e ofruara nga vetë shtetet nuk kanë dhënë gjithmonë rezultatin e kërkuar dhe një nga arsyet është se vetë individët nuk janë të mirëinformuar sesi duhet të veprojnë për arritjen e një kontrolli efikas mbi të drejtat dhe liritë e tyre. Për të patur besim te instancat gjyqësore, individit duhet t'i faktohet se ai do të ketë standartet minimale në një gjykim civil dhe pikërisht një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e drejtë. Deri diku me anë të ndikimit të faktorëve kombëtare (KLD) dhe atyre ndërkombëtare (BE, OSBE etj) është bërë e mundur rritja e besueshmërisë ndaj gjykatave por jo në nivelet e duhura. Kjo ka ardhur për shume arsye që do të trajtohen dhe në vazhdim, por më kryesorja është se individët në shumicën e tyre janë të bindur se për të marrë drejtësi nga gjykatat, të cilat e kanë për detyrë me ligj për t'a bërë një gjë të tillë, duhet të paguajnë. Ky konstatim nuk është i pabazuar pasi shpesh jemi njohur nepërmjet mediave të rasteve konkrete në të cilat drejtësia barazohet me ryshfetin dhe politikën.

Që nga rrëzimi i komunizmit e deri më sot, çdo qeveri apo parti politike është munduar të respektojë parimin e ndarjes së pushteteve, por jo gjithmonë është ruajtur ky ekuilibër. Nuk ka qenë pushteti gjyqësor që ka ndikuar te qeveria (pushteti ekzekutiv), por më shumë kjo e fundit te gjyqësori. Pa diskutim kjo ka sjell shtrembërim të qëllimeve dhe synimeve të pushtetit gjyqësor, duke prodhuar në fund, vendime qoftë penale apo civile, të padrejta.

Përmes dhënies së kuptimit të “gjykimit civil të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe që realizohet brenda një afati të arsyeshëm kohor” dhe analizës së rasteve konkrete nga praktika shqiptare apo europiane kërkohet të arrihen këto qëllime në fund të punimit:

- a. nxjerrja në pah e kuptimit të gjykimit civil;
- b. kuptimi i procedurave gjyqësore dhe administrative;
- c. rëndësia e realizimit të një gjykimi civil sipas rregullave të paracaktuara nga ligji, pikërisht në respektim të “proçesit të rregullt e të drejtë gjyqësor”;
- d. zbulimi i atyre faktorëve që ndikojnë te gjykimi civil, duke e shtrembëruar atë;
- e. analizimi i një gjykimi civil me cen në vetvete (duke u ndalur vetëm te tri elementë të të drejtës për një proçes të drejtë gjyqësor) dhe pasojat e tij;

f. mjetet juridike dhe faktorë të ndryshëm që mund të ndihmojnë në realizimin e një gjykimi civil nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.